

AKT - THEMELIMI

I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) SHPK

Sot, me date 24.06.2009, perpara meje Mimoza SADUSHAJ, notere ne Dhomen e Notereve Tirane, me seli ne Tirane ne: Rruga "Vaso Pasha" pall. 13, u paraqit personalisht:

- Arben NGRAÇANI, i biri Isufit, i dtl. 12.07.1969, banues ne Berat ne adresen: Rruga "30 Dhjetori", pallati 6 katesh prane Deges Ushtarake, kati 5, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z1097922,

I cili ne cilesine e ortakut te vetem themelues me kerkoi perpilimin e ketij akti themelimi te shoqerise "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk

Me nenshkrimin e ketij akti themelimi, nenshkruesi dhe themeluesi i saj merr persiper te realizoje e te respektoje te drejtat dhe detyrimet e permendura me poshte ne statutin e shoqerise, ligjin tregtar, normat kushtetuese, te zakoneve te mira etj.

**Neni 1 Emertimi**

Ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" eshte formuar shoqeria e emertuar "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk.

**Neni 2 Struktura**

UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES eshte shkolle e larte e nivelit universitar dhe pasuniversitar dhe fillimisht do te kete dy fakultete, perkatesisht:

- 1-) Fakulteti i mesuesise, me keto dege:
  - a-) Mesues i Ciklit te Ulet
  - b-) Mesues i Gjuhes Angleze
- 2-) Fakulteti i Shkencave te Edukimit dhe Infermierise, me keto dege:
  - a-) Pedagogji - Psikologji
  - b-) Gazetari me drejtim edukimi
  - c-) Infermieri e Pergjithshme me drejtim shkolle.

**Neni 3 Selia**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Fran Bardhi", Vila nr.1, Selite, Tirane

**Neni 4 Kozhezgjatja**

Kozhezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pacaktuar duke filluar nga dita kur shoqeria fiton personalitetin juridik, pra regjistrohet si person juridik ne QKR. Megjithate ajo mund te prishet ne cdo kohe me vendim te organit kompetent.

1

**Neni 5 Sbtirija ne hapesine**

Si rregull, aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise por dhe jashte ketij territori, me hapjen e degeve e fakultete te reja, zyryave apo filialeve te saja jashte selise apo nepermjet veprimtarive te tjera brenda kuadrit te realizimit te objektit te shoqerise, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

**Neni 6 Objekti**

Objekti i aktivitetit te shoqerise "UNIVERSITETI PEDAGOGJIK I TIRANES" (U.P.T) shpk, do te jete:

- 6.1 Administrimi dhe drejtimi didaktik i institucionit arsimor te larte, jo publik, universitar dhe pasuniversitar si dhe aktivite te tjera ndihmese per kete lloj veprimtarie.
- 6.2 Kryerja e kualifikimeve shkencore pasuniversitare, kurseve te specializimit dhe kurseve te kualifikimit afatshkurter dhe afatgjate me qellim pergatitjen e specialisteve ne fushen e mesuesise, pedagogjise, psikologjise, gazetarise, infermierise se pergjithshme si dhe ne fusha te tjera te shkences.
- 6.3 Kryerja e studimeve, kerkimeve dhe botimeve ne fusha te ndryshme te shkences.  
Pervex sa siper, ne aktivitetin e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjetër qe do te konsiderohet nga ortakut vetem e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

**Neni 7 Kapitali themeltar**

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 (nje milion) leke dhe perbehet nga 100 kuota me vlere nominale 10.000 leke secila. Ky kapital eshte shlyer plotesisht nga ortakut i vetem.
- 7.2 Me regjistrimin dhe licensimin e shoqerise nga organet kompetente si dhe me realizimin e praktikës ligjore kjo shoqeri gjate aktivitetit te saj mund te zmadhoje apo te zvogeloje kapitalin e saj themeltar ne perputhje me procedurat e percaktuara ne Statutin e shoqerise dhe ne ligjin tregtar shqiptar.

**Neni 8 Organet dhe autoritetet drejtuese**

- 8.1 Organet drejtuese dhe vendimarrse te shoqerise jane;
  - Ortaku i Vetem (qe njehsohet me Asamblene e Ortakeve).
  - Administratori perfaqesuesi ligjor i shoqerise
- 8.2 Autoriteti drejtues i UNIVERSITETIT PEDAGOGJIK I TIRANES eshte Rektori i cili e perfaqeson ate dhe vepron ne emer dhe per llogari te tij. Autoriteti drejtues per secilin nga Fakultetet eshte Dekani qe eshte ne te njejtën kohe dhe perfaqesuesi ligjor i tyre.
- 8.3 Rektori dhe dekanet emerohen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise. Marredheniet financiare te autoriteteve drejtuese rregullohen me kontrate te vecante.
- 8.4 Per zhvillimin e veprimtarise se tij, Universiteti krijon organet e veta si Senati, Keshillat e Fakulteteve dhe Departamentet te cilet organizohen dhe funksionojne sipas Rregullores se (U.P.T).

2

**Neni 9 Administrimi**

- 9.1 Administratori eshte organi ekzekutiv i shoqerise.
- 9.2 Ortaku i Vetem emerion Administrator te shoqerise z. Gjovalin DAKA, i biri Kolit, i dtl. 02.05.1954 lindur e banues ne Lushnje, me adrese; lagja "Skender Libohova" rruga "Uani Kondakciu".
- 9.3 Mandati i administratorit eshte 5 vjeçar, me te drejte rizgjedhjeje.
- 9.4 Kompetencat e administratorit jane percaktuar te statutin e shoqerise.

**Neni 10 Te ndryshme**

Ky Akt Themelimi hartohet ne gjuhen shqipe, ne 4 ekzemplare originale duke patur secili vlere te barabarte ligjore e kuptimore.  
Akti i Themelimit hartohet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne pergjithesi, rendin juridik, rregullat e "zakoneve te mira" dhe ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ne vecanti.  
Ortakut i Vetem i shoqerise pasi u njoh dhe kuptoi drejt te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga kontrata, e gjeti te drejte e konform vullnetit te tij te brendshem dhe e firmosi rregullisht ate.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

Arben NGRAÇANI

Arben Ngraçani

NOTERI



Gjovalin Daka

Arben Ngraçani

3